



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

VENDIM

Nr. 10, dt. 15.06.2022

MBI PËRDORIMIN E FONDIT REZERVË TË KËSHILLIT TË QARKUT PËR VITIN 2022

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 77, Ligjit Nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit “Për buxhetin e vitit 2022”, Udhëzimeve të Ministrisë së Financave për zbatimin e buxhetit të vitit 2022, Vendimin e Këshillit të Qarkut nr. 14 datë 22.12.2021 “Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2022”, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut

V E N D O S I

1. Të miratojë përdorimin e Fondit Rezervë të Këshillit të Qarkut për vitin 2022 në vlerë 300 mijë lekë.
2. Fondi prej 300 mijë lekë do të përdoret si kontribut financiar për Universitetin Fan S. Noli në kuadër të zbatimit të Projektit “Zhvillimi i shkencave në frëngjisht në Europën Qëndrore e Lindore” për mbulimin e pjesës së akomodimit për një lektor francez, për një periudhë 10 mujore.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e financës, zhvillimit ekonomik, shërbimeve, burimeve njerezore dhe zhvillimit të territorit, të gjithë zyrat e administratës së Këshillit të Qarkut, Dega e Thesarit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ana VERUSHI

Kryetari i Këshillit të Qarkut

Konceptoi O.Beqiraj
Juristi Gj. Kristo
Sek. K.Qarkut B. Muço





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

RELACION

MBI PËRDORIMIN E FONDIT REZERVË TË KËSHILLIT TË QARKUT PËR VITIN 2022

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 77, Ligjit Nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit “Për buxhetin e vitit 2022”, Udhëzimeve të Ministrisë së Financave për zbatimin e buxhetit të vitit 2022, Vendimin e Keshillit të Qarkut nr. 14 date 22.12.2021 “Mbi miratimin e buxhetit të Keshillit të Qarkut për vitin 2022”, Drejtoria e financës, zhvillimit ekonomik, shërbimeve, burimeve njerëzore dhe zhvillimit të territorit paraqet para Keshillit të Qarkut kërkesen për përdorimin e fondi rezervë për vitin 2022.

Universiteti Fan S. Noli, në bashkëpunim me Këshillin e Qarkut, në kuadër të strategjive dhe politikave të ndjekura për përmiresimin e programeve të studimit dhe nivelit të studentëve, kërkon të përfitojë nga mundësia e ofruar nga AUF (Agjensia Universitare e Frankofonise) për të sjellë në Korçë lektorë francezë nga të cilet do të përfitojnë studentë të disa programeve të studimit.

Zbatimi i Projektit “Zhvillimi i shkencave në frëngjisht në Evropën Qëndrore e Lindore”, do të rrisë cilësinë e studentëve në gjuhën frënge pranë këtij Universiteti. Gjithashtu përfitues do të jenë edhe Seksioni Dygjuhësh në Shkollën “Raqi Qirinxhi” dhe Aleanca Franceze Korçë.

Projekti mbulon periudhën prej 10 muajsh për vitin akademik 2022-2023 (Shtator 2022 – Qershor 2023).

Këshilli i Qarkut si pjesë e këtij Projekti do të marrë përsipër të bashkëfinancojë projektin në pjesën e akomodimit të një lektori për një periudhë 10 mujore me një maksimum qeraje 250 eurc në muaj, në vlerë totale 2500 euro ose 300000 lekë.

Sa më sipër i kerkojmë Këshillit të Qarkut të miratojë përdorimin e fondit rezervë në masën 300 mijë lekë për financimin e Projektit “Zhvillimi i shkencave në frëngjisht në Evropën Qëndrore e Lindore” dhe transferimin e këtij fondi për Universitetin Fan S. Noli.

Korçë, më 13.06.2022

Oljona Beqiraj
Specialiste e Financës